

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Turpi ka emër: Gjykata e Hagës dhe të marrët politikanë - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/turpi-ka-emer-gjykata-e-hages-dhe-te-marret-politikane/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:51:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:37:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	730dafa06c6f37ed3426e8b28ea00bf907739061fb4e6d12fb538d7be3bedd8d
TEKSTI	a5aa25b82ebfb50630c5e07b8921aa0e1a0419e0ffdf6da2a66ff2a88e4a4367
PAMJA	d3e41a7ad72a6852f6d6d829d58fc8d48f714cd28d450125b006f71ee9c4b2de

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aa1fde4ea01b6d569d325e0c8ad4f3ae88d44e6e59e10250ed14e0e7ddfcd0f4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aa1fde4ea01b6d569d325e0c8ad4f3ae88d44e6e59e10250ed14e0e7ddfcd0f4>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Turpi ka emër: Gjykata e Hagës dhe të marrët politikanë

by Lajm Lajm — September 16, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Nga Boldnews.al

Në gjithë shqiptarinë kjo është dita më e errët. Lëndimi i shpirtit mbetet më i madh se ikja fizike, por mendja duhet të jetë tashmë e në vijim më e kthjellët se kurrë për të kuptuar se sa vlejme në sytë e Europës, sa dëm i bëjmë vetes për pushtet personal dhe si vetëdijemi në çaste historike.

Aty në Hagë nuk u dha vetëm vendimi për dënimin me 81 vite burgim të ish-drejtimesve të UÇK-së Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi për krime lufte, por bashkë me të u tentua të damokosej një luftë e drejtë çlirimtare, duke përdhosur gjakun e dëshmorëve dhe mbi 20 mijë viktimave të pafajshme.

Proceduralisht ka një ndarje për "krimet e luftës si norganizatë", si UÇK dhe krimet individuale të të dënuarve, por duke mos harruar kurrë që ata përfaqësonin uniformën e UÇK-së. Imazhi i luftës së drejtë çlirimtare u bë pis nga pisat e vërtetë që mbajnë veshur kostumin e politikanit dhe lobeve që yshtin veladonët e Gjykatës Speciale të dilnin në këtë përfundim.

Para se të drejtojmë gishtin nga lobimet ruso-sllave që e patën të lehtë të depërtonin në atë Europën e veshur si gjyqtarë e prokurorë "të drejtë", duhet të kthejmë edhe sytë nga vetja, për të mos gjykuar me zemër të lënduar, por mendjen e kthjellët. Krijimi i kësaj gjykate paradoksalisht erdhi me votat edhe të atyre që sot u dënuan, me përjashtim të Rexhep Selimit.

Kjo gjykatë u ngrit që të hetonte të ashtëquajtura "krimet monstruoze" siç ishin akuzat për trafik organesh, duke sjellë edhe një raport të zi nga Dik Marty, një eurodeputet zvicëran që nxiu dhe hodhi dyshime se kishte zbuluar "shtëpinë e vardhë" në Mat. Që në çastin që "trafiku i organeve" jo vetëm nuk kishte një provë sado periferike, kjo gjykatë duhej shkrire, por naivët në politikë, (maja e saj në Tiranë dhe Prishtinë) u besuan "garancive" të sharlatanëve që të tundin pasaportën më të fuqishme të botës...

TË FUNDIT

Turpi ka emër: Gjykata e Hagës dhe të marrët politikanë

SEPTEMBER 16, 2026

Plagosje me armë zjarri në Durrës

SEPTEMBER 16, 2026

Arkitekt i vilës së Ballukut/ Olsi Eftimi del nga SPAK, "kyç" gojën për gazetarët

SEPTEMBER 16, 2026

Tubacioni i Bogovës pëson defekt, Berati, Kuçova dhe fshatrat përreth mbeten pa ujë

SEPTEMBER 16, 2026

Besmir Beja i Doganave rrit taksën e zhdoganimit të makinave me urdhër të brendshëm

SEPTEMBER 16, 2026

PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë

SEPTEMBER 16, 2026

Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri

SEPTEMBER 16, 2026

A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkrire Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë?

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit

SEPTEMBER 16, 2026

Dokumenti/ Publikohet aktgjykimi i plotë për ish-krerët e UÇK-së

SEPTEMBER 16, 2026

Gjithë ajo "kokë e madhe" si kryeministri Edi Rama u ngrit nga Tirana dhe shkoi në Prishtinë për të "ndërmjetësuar" në vitin 2015 votimin për ngritjen e kësaj gjykate. Ashtu u bë me duartrokitje, pa e kuptuar se interesat e momentit gjeopolitike sa rajonale aq edhe botërore kërkonin ca haraçe jo të vogla në kurriz të Kosovës që mbante ende plagët e luftës të hapura.

Sot të marrët sharlatanë, që jepen pas pushtetit personal të momentit, futën nën dhe' idealet dhe luftë e një kombi nën stemën e UÇK-së. Tashmë po ankohet se ata (serbët) kanë lobuar fuqishëm që të dënoheshin katër ish-drejtesit e lartë të UÇK-së, pa kthyer sytë nga vetja se janë gati të llobojnë kudo, duke derdhur miliona dollarë edhe për të bërë një foto...! Apo jo? Të marrë!!!!

Tags: denim me burg gjykata e hages Hashim Thaçi Jakup Krasniqi kadri veseli rexhep selimi uck

Previous Post

Plagosje me armë zjarri në Durrës



Lajm Lajm

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES